

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Mprehtësia shpirtërore¹ / *el-Firaaseh* / الْفِرَاسَةِ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"إِنَّ فِي ذَلِكَ لآيَاتٍ لِّلْمُتَوَسِّمِينَ"

“Vërtet në këtë ka shenja për ata që dallojnë gjërat.” (el-Hixhr, 75)

Tewessum (aftësia njohëse) është sinonim i *Firaaseh* (mprehtësisë shpirtërore). *Firaaseh* është të kuptuarit e një çështjeje të së padukshmes pa shenja të qarta treguese ose pa përvojë empirike.² Kjo ka tri nivele.

¹ *Firaaseh* ka të bëjë me aftësinë e parashikimit të mirë. Poseduesi i kësaj cilësie mund t'i njohë njerëzit pavarësisht sjelljes së tyre dhe mund të shohë atë çfarë të tjerët nuk shohin, prandaj dhe të parashohë atë çfarë të tjerët nuk parashohin. Nganjëherë kjo realizohet nëpërmjet mprehtësisë në njohjen e sinjaleve të holla (të imëta), por ajo çfarë shejhu flet këtu, kryesisht ka të bëjë me atë që del nga frymëzimi (*ilhaam*) ose zbulimi (*keshf*).

² E padukshmja është një rrafsh ekskluziv i Allahut, i cili tha:

“Thuaj: ‘Përveç Allahut, askush në qiej e as në tokë nuk e di të padukshmen.’” (en-Neml, 65)

Allahu nganjëherë ka lënë peygamberët të dinë diçka rreth të padukshmes. Ai tha:

“Allahu nuk jua zbulon të fshehtë, por Ai zgjedh nga të Dërguarit e Tij kë të dojë.” (Al-Imran, 179)

Dallimi mes dijes së të Dërguarve dhe asaj të Allahut qëndron në atë se dija e tyre varet nga lejimi i Tij dhe është e kufizuar. Për këtë shkak, Ai instrukttoi peygamberin të thoshte:

“Thuaj: ‘Unë nuk posedoj (fuqinë për të sjellë) dobi a dëm, përveç si ka dashur Allahu. Sikur ta dija të fshehtë (të padukshmen), do t'i shtoja të mirat dhe asnjë e keqe s’do të më prekte.’” (el-A’raf, 188)

Niveli i parë: Mprehtësia shpirtërore kalimtare dhe e rrallë, që zbret në gjuhën e paedukuar një herë në jetë për nevojën e një ndjekësi të sinqertë në shtegun e pastrimit shpirtëror. Arsyeja e shprehjes së saj nuk mund të gjurmohet dhe shprehësi i saj është i parëndësishëm. Kjo është diçka që s'mund të dallohet nga parashikimi dhe të ngjashmet me të, meqë nuk i referohet sigurisë së ndodhjes, nuk vjen nga dija dhe nuk nxitet nga një gjendje ekzistuese.³

Niveli i dytë:

- Mprehtësia shpirtërore që është fryti i imanit
- Gufon nga gjendja (*haal*) e njëmendtë
- Shkëlqen me dritën e zbulimit

Niveli i tretë:

- Mprehtësia shpirtërore më fisnike,
- Që nuk prodhohet nëpërmjet të menduarit,
- Por del nga gjuhët e zgjedhura ose në mënyrë të qartë, ose nëpërmjet simbolikës.

Disa njerëzve mund t'u jepet diçka nga dija e së padukshmes nëpërmjet frymëzimit (*ilhaam*) ose zbulimit (*keshf*). Dija e tyre është e ndryshme nga ajo e të Dërguarve në dy mënyra. Së pari, nuk është e sigurt. Personi i frymëzuar (*muhaddeth*) i këtij umeti, Umeri ؓ, nuk qe në gjendje të shihte atë çfarë pa Ebu Bekri ؓ në rastin e Hudejbijes ose në rastin e fitnes së daljes nga feja (të fiseve arabe). Së dyti, kjo nuk tregohet me qëllim që të arrihet besueshmëri. Të Dërguarve u duheshin mrekullitë (*muxhizaat*; shfuqizimi i përkohshëm i rendit natyror nëpërmjet ndërhyrjes hyjnore), sepse kishte nevojë që njerëzit t'i bindeshin udhëzimit që ata ua sillnin nga Zoti. Kjo s'është e njëjtë me *keramaat* (favoret), që janë dukuri të mbinatyreshme sikurse mrekullitë dhe ndodhin vetëm për ta nderuar ose për ta ndihmuar personin që i ndodh ose tjetërkënd.

³ Një goditje e mirë nga një gjuajtës i keq. Urtësia mund të vilet edhe nga zemrat e paedukuara.